

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1808/8 Prot

Durrës, më: 24.07.2025

V E N D I M

Nr. 68, datë 24.07.2025

PËR

**"MIRATIMIN E TARIFËS SË STUDIMIT PËR PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË
TË STUDIMIT NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës PËR
VITIN AKADEMIK 2025-2026"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 3 "*Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë*", pika 3/ç ku citohet se: "*Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë lig*"; në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; në Vendimet respektive të Bordit të Administrimit për miratimin e tarifave të studimit, si dhe në relacionin Nr. 1721/1 prot., datë 11.07.2025 të Drejtorisë së Administrimit Financiar, vendim Senati Akademik 83, datë 21.07.2025, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifave të studimit, për studentët të cilët regjistrohen, në një program të ciklit të dytë të studimeve, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve fitues, të cilët do të regjistrohen për herë të parë, në një program të parë studimi të ciklit të dytë, do të jetë 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë.
3. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve fitues të cilët do të regjistrohen për herë të parë, në një program të dytë studimi të ciklit të dytë, do të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.
4. Tarifa e aplikimit për studentë të cilët do të aplikojnë për të transferuar studimet në një program të parë të ciklit të dytë, nga një universitet tjetër në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës do të jetë 3 000 (tre mijë) lekë.
5. Tarifa e aplikimit për studentë të cilët do të aplikojnë për të transferuar studimet në një program të dytë të ciklit të dytë nga një universitet tjetër në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës do të jetë 5 000 (pesë mijë) lekë.
6. Studentët të cilët do të regjistrohen në një program studimi të ciklit të dytë me 120 kredite, (me kohëzgjatje normale dy vjecare) do të paguajnë tarifën e shkollimit në tre këste. Kësti i parë, në masën 25% të tarifës së plotë, **do të paguhet menjëherë në momentin e regjistrimit**, kësti i dytë në masën 25% të tarifës së plotë të shkollimit